

*LËVIZJET E SHTETASVE NË SHQIPËRI

Gusht 2026

Gjatë muajit Gusht 2026, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 3.459.588 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 2,7 %, krahasuar me Gusht 2025.

Gjithashtu, 3.571.685 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 7,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Hyrjet në Shqipëri:

- Shtetas shqiptarë: 1.030.056 (rritje me 4,4 %)
- Shtetas të huaj: 2.429.532 (rritje me 2,0 %)

Daljet nga Shqipëria:

- Shtetas shqiptarë: 1.054.978 (rritje me 6,1 %)
- Shtetas të huaj: 2.516.707 (rritje me 7,5 %)

FIG. 1 LËVIZJET E SHTETASVE NË SHQIPËRI, GUSHT 2025 - GUSHT 2026



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

TAB. 1 LËVIZJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE TË HUAJ

Periudha	Gusht 2025	Gusht 2026	Ndryshimi vjetor %	Janar - Gusht 2025	Janar - Gusht 2026	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	3.368.104	3.459.588	2,7	14.629.061	15.452.553	5,6
Shqiptarë	986.240	1.030.056	4,4	5.660.059	6.008.853	6,2
Të Huaj	2.381.864	2.429.532	2,0	8.969.002	9.443.700	5,3
Dalje Gjithsej	3.335.824	3.571.685	7,1	14.581.228	15.363.245	5,4
Shqiptarë	994.573	1.054.978	6,1	5.765.761	6.037.056	4,7
Të Huaj	2.341.251	2.516.707	7,5	8.815.467	9.326.189	5,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

*Shënim për përdoruesit:

Në vijim të disa ndryshimeve nga raportimi i të dhënave nga burimi administrativ, gjatë procesit të kontrollit dhe validimit INSTAT ka evidentuar disa mospërputhje në tregues të caktuar të disagreguar të statistikave mbi lëvizjet e shtetasve.

Për të garantuar cilësinë, krahasueshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit statistikor, në publikimin për muajin Gusht 2026, këta tregues do të paraqiten përkohësisht vetëm në nivel më të agreguar ku të dhënat plotësojnë kushtet e besimit të variablave.

INSTAT, në bashkëpunim me burimin administrativ, po vijon procesin e verifikimit dhe harmonizimit të serisë kohore. Treguesit e detajuar do të publikohen pas përfundimit të këtij procesi dhe sigurimit të konsistencës së të dhënave.

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person, që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti, llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person, që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti, llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambientit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi i vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”. neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtare, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e shqiptarëve, të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.